



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



### Heqje dorë nga përgjegjësia:

Jeni të lutur të vini re se ky dokument përbën një konsolidim jozyrtar të destinuar vetëm për qëllime informimi. Teksti nuk jep asnjë të drejtë dhe nuk imponon asnjë detyrim të ndryshëm nga çfarë parashikohet në legjislacionin e miratuar dhe të botuar në Fletoren Zyrtare. EURALIUS nuk garanton saktësinë dhe nuk mban përgjegjësi për përdorimin që mund t'i bëhet informacionit të mëposhtëm.

## R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

### KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

#### RREGULLA PËR PËRZGJEDHJEN ME SHORT TË ÇËSHTJEVE NË PROCESIN E VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT

#### Kreu I

#### Parime të përgjithshme

1. Përzgjedhja e çështjeve me short realizohet pas fillimit të procedurës së vlerësimit dhe është pjesë përbërëse e kësaj procedure.
2. Përzgjedhja e çështjeve me short realizohet në mënyre elektronike nga administrata gjyqësore. Kur kjo nuk është e mundur shorti zhvillohet në mënyrë manuale.
3. Shorti zhvillohet në ambientet e gjykatës ku gjyqtari ka ushtruar më gjatë detyrën gjatë periudhës së vlerësimit.
4. Shorti konsiston në një përzgjedhje rastësore të çështjeve dhe realizohet në mënyrë transparente në praninë e detyrueshme të nëpunësit përgjegjës për vlerësimin, të kancelarit, një sekretareje gjyqësore dhe të nëpunësit të gjykatës që punon në fushën e teknologjisë së informacionit. Kanë të drejtë të marrin pjesë, vetë gjyqtari subjekt vlerësimi, çdo anëtar i Komisionit për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale si dhe një punonjës IT i KLGJ-së.
5. Data, ora dhe vendi i zhvillimit të shortit përcaktohen me vendim të relatorit, i cili i njoftohet gjyqtarit, kancelarit dhe kryetarit të gjykatës, jo më vonë se 2 ditë para ditës së organizimit të shortit.
6. Kryetari dhe kancelari i gjykatës marrin masa për t'i krijuar nëpunësit përgjegjës të gjitha kushtet e nevojshme për ushtrimin e detyrës.
7. Mbi bazën e tabelave statistikore dhe seksionin ku ka ushtruar detyrën gjyqtari, relatori përcakton me vendim numrin dhe kategoritë e çështjeve që do të përzgjidhen me short, për secilin vit vlerësimi. Përzgjedhja duhet të jetë e tillë që të përfaqësojë të gjithë punën profesionale të gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

8. Nëse gjatë periudhës së vlerësimit gjyqtari ka munguar në detyrë për më shumë se 6 muaj, numri i çështjeve që përzgjidhen për vlerësim etik dhe profesional, përkatësisht 15 ose 6 çështje për vlerësim të përgjithshëm dhe jo më shumë se 6 ose 3 çështje për ato të vendosura tej afateve standarde, në varësi të periudhës së vlerësimit, do të ulet në mënyrë proporcionale me kohën.
9. Në short përfshihen të gjitha çështjet në të cilat gjyqtari ka qenë relator i trupit gjykues, duke përfshirë edhe ato të përfunduara prej tij si i transferuar për kohësisht apo i caktuar për çështje të veçanta, në një gjykatë tjetër nga ajo ku ai ushtron funksionin.

## Kreu II

### **Kriteret mbi të cilat relatori përcakton numrin dhe kategoritë e çështjeve që do të përzgjidhen me short**

10. Numri total i çështjeve që do të përzgjidhen me short përcaktohet nga relatori në zbatim të nenit 91 të Ligjit për Statusin, në varësi të periudhës së vlerësimit, bazuar në kriteret e mëposhtme:

- a. **Kriteri vjetor për vlerësimin e përgjithshëm.**

Sipas këtij kriteri, relatori përcakton numrin e çështjeve që do të përzgjidhen për procesin e vlerësimit referuar periudhës së vlerësimit, si më poshtë :

- i. nëse vlerësimi është pesëvjeçar, do të përzgjidhen 3 çështje për çdo vit kalendarik.
- ii. nëse vlerësimi është trevjeçar, do të përzgjidhen 5 çështje për çdo vit kalendarik.
- iii. nëse vlerësimi është 1 vjeçar (i përshpejtuar), do të përzgjidhen 6 çështje.

- b. **Kriteri i vonesës në afate.**

Sipas këtij kriteri relatori përcakton numrin e çështjeve që do të përzgjidhen sipas vonesës në afate, referuar tabelës së hartuar nga nëpunësi përgjegjës, menjëherë pas fillimit të procesit të vlerësimit, sipas formatit standard (Aneksi i bashkëlidhur këtij akti). Nëse gjyqtari ka çështje të gjykuara përtej afateve standarde (ligjore dhe standard minimal kohor), atëherë prej tyre përzgjidhen 5 %, por jo më shumë se 6 çështje. Në rastin e vlerësimit 1 vjeçar, numri i çështjeve që përzgjidhen është sërish 5 %, por jo më shumë se 3 çështje.

11. Numri i çështjeve që do të përzgjidhen me short, për vlerësim të përgjithshëm, sipas kategorive, përcaktohet nga relatori në zbatim të nenit 91 të Ligjit për Statusin, në varësi të periudhës së vlerësimit, bazuar në kriteret e mëposhtme:

- a. **Kriteri gjithëpërfshirës i përzgjedhjes**

Sipas këtij kriteri, relatori duhet të kujdeset që përzgjedhja të mbulojë plotësisht të gjitha llojet e çështjeve të gjykuara nga gjyqtari subjekt vlerësimi. Për këtë qëllim relatori përcakton numrin e çështjeve që do të përzgjidhen mbi bazën e tabelave statistikore, ku përfshihen edhe çështjet e përfunduara nga gjyqtari në një gjykatë tjetër nga ajo ku ai ka ushtruar funksionin, si i transferuar për kohësisht, apo i caktuar për

çeshtje të veçanta. Për lehtësimin e punës dhe zhvillimin e shortit, menjëherë pas fillimit të procesit të vlerësimit, mbi bazën e tabelave statistikore të dërguara, nëpunësi përgjegjës për vlerësimin, nën mbikëqyrjen e relatorit, përfshin në një tabelë të vetme statistikore sipas natyrës së çeshtjes, ato të përfunduara në të njëjtin vit kalendarik, në gjykata të tjera ku gjyqtari ka qenë i transferuar apo caktuar për gjykimin e çeshtjeve të veçanta.

#### **b. Kriteri i barazisë në përzgjedhjen e çeshtjeve**

Sipas këtij kriteri, relatori përcakton numrin e çeshtjeve që do të përzgjidhen, në varësi të numrit të çeshtjeve të përfunduara, me qëllim përzgjedhjen në mënyrë të barabartë të çeshtjeve për secilën kategori, në varësi të raportit që zë numri i çeshtjeve të përfunduara për secilën kategori/tabelë, në numrin total të çeshtjeve.

#### **c. Kriteri i natyrës së vendimit**

Sipas këtij kriteri, relatori, pas përcaktimit të numrit total të çeshtjeve që duhet të përzgjidhen (vlerësim i përgjithshëm + çeshtjet e vonesës në afate), përcakton numrin maksimal të çeshtjeve të përfunduara me vendim jopërfundimtar që duhet të merren për vlerësim, nëse shorti do të përzgjedhë të tilla. Ky numër nuk duhet të jetë më i lartë se 10 % e numrit të përgjithshëm të çeshtjeve të përzgjedhura.

#### **ç. Kriteri i kompleksitetit të çeshtjes**

Sipas këtij kriteri, relatori përcakton numrin e çeshtjeve pa palë kundërshtare që duhet të përzgjidhen si kategori më vete, në varësi të raportit që zënë çeshtjet e përfunduara pa palë kundërshtare në numrin total të çeshtjeve. Ky numër nuk duhet të jetë më i lartë se 20 % e numrit të përgjithshëm të çeshtjeve të përzgjedhura. Bazuar në tabelat statistikore, relatori përcakton kategorinë dhe vitin kalendarik nga i cili këto çeshtje do të përzgjidhen me short.

### **Kreu III**

#### **Rregullat e zhvillimit të shortit në gjykatë**

12. Shorti zhvillohet mbi bazën e listës së plotë të çeshtjeve gjyqësore të gjykuara nga gjyqtari.
13. Procedura e shortit ndjek disa hapa përzgjedhjeje të çeshtjeve sipas vendimit të relatorit e radhës së mëposhtme.
14. Çdo hap përzgjedhjeje bazohet në të dhëna statistikore pjesë e një table të caktuar për kategori çeshtjesh.
15. Procedura e shortit fillon me përzgjedhjen në mënyrë rastësore të çeshtjeve për të cilat është vendosur përtej afateve standarde, bazuar në formatin tabelar të hartuar nga nëpunësi përgjegjës për vlerësimin.
16. Më pas vazhdohet me përzgjedhjen e çeshtjeve për vlerësimin e përgjithshëm sipas kategorive të çeshtjeve e tabelave statistikore të përcaktuara në vendimin e relatorit. Në përzgjedhjen e çeshtjeve për vlerësim të përgjithshëm, përjashtohen ato që janë përzgjedhur sipas pikës 15.
17. Për të kontrolluar nëse çeshtja e përzgjedhur me short përmbush kriteret e nenit 91 të Ligjit për Statusin dhe të këtyre rregullave, do të procedohet aty për aty me verifikimin fizik të vendimit

gjyqësor, që ka zgjidhur çështjen. Nëse çështja nuk përmbush kriteret, atëherë ajo nuk konsiderohet dhe procedohet me përzgjedhjen e një çështjeje tjetër. Çështje e përzgjedhur me short nuk konsiderohet as ajo, vendimi gjyqësor i të cilës është përzgjedhur për vlerësim nga gjyqtari, sipas nenit 86 të Ligjit për Statusin.

18. Gjykata/t e tjera duhet të bashkëpunojnë, duke dërguar në kohë reale në vendin ku zhvillohet shorti, kopje të vendimeve, nëse ato përzgjidhen nga shorti. Për të verifikuar që çështjet e përzgjedhura përmbushin kriteret e shortit, dërgimi duhet të bëhet menjëherë me faks ose me postë elektronike, duke u dokumentuar në procesverbalin e shortit.

#### **Kreu IV**

##### **Dokumentimi i shortit dhe vëzhgimi i dosjeve**

19. Çdo veprim i kryer gjatë procedurës së shortit dokumentohet në një procesverbal, sipas formës standarde të miratuar.
20. Ky procesverbal mbahet nga një sekretare gjyqësore dhe nënshkruhet nga të gjithë të pranishmit. Nëse ka vërejtje për procedurën e zhvillimit të shortit, ato shënohen në një rubrikë të veçantë të procesverbalit.
21. Një kopje e procesverbalit i dorëzohet kancelarit të gjykatës për përgatitjen e dosjeve të përzgjedhura. Një kopje i dorëzohet gjyqtarit, ndërsa kopja origjinale bëhet pjesë e dosjes së vlerësimit.
22. Pas dokumentimit të shortit bëhet vëzhgimi i dosjeve për të parë nëse ato ndodhen në arkivën e gjykatës ku është zhvilluar shorti. Kancelari merr masa për fotokopjimin e të gjitha akteve të dosjeve të përzgjedhura, me përjashtim të fashikullit të prokurorit në çështjet penale dhe ia përcjell ato Këshillit jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga e nesërmeja e zhvillimit të shortit.

Aktet e dosjeve të përzgjedhura duhet të jenë të inventarizuara dhe të njësuara me vulën e gjykatës. Bashkë me aktet e fotokopjuara e të njësuara me origjinalin, duhet të dërgohet edhe kopja e regjistrimit audio të seancave.

23. Nëse pas vëzhgimit të dosjeve rezulton se ato ndodhen në arkivën e një gjykate tjetër, nëpunësi përgjegjës për vlerësimin, njofton relatorin dhe me miratimin e tij i kërkon gjykatës tjetër, kopje të akteve të dosjes së përzgjedhur sipas procedurës dhe afateve të mësipërme.

#### **Kreu V**

##### **Dispozita kalimtare për gradimin/përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarëve që kanë kaluar procesin e rivlerësimit**

24. Për gradimin/përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, përzgjidhen me short për vlerësim 6 dosje shtesë. Nga kjo përzgjedhje, përjashtohen çështjet që janë pjesë e dosjes së rivlerësimit, sipas nenit 171 pika 5 të Ligjit për Statusin. Për të lehtësuar punën e procedurën e shortit, nëpunësi përgjegjës për vlerësimin, evidenton paraprakisht çështjet e dosjes së rivlerësimit, të përzgjedhura nga gjyqtari, nga shorti, apo të analizuar mbi bazën e ankesave.

25. Përzgjidhen si pjesë e 6 dosjeve shtesë, vetëm çështjet me palë kundërshtare, për të cilat është disponuar me vendim përfundimtar.
26. Për zhvillimin e shortit, dokumentimin dhe dërgimin e dosjeve të përzgjedhura, zbatohen rregullat e mësipërme.

### **Aneks I**

#### **Format tabelar për çështjet e vendosura jashtë afateve standarde**

Ky format hartohet nga nëpunësi përgjegjës për vlerësimin dhe përmban të listuara vetëm çështjet me palë kundërshtare të përfunduara nga gjyqtari tej afateve standarde, në dy kolona:

- (1) numrin rendor që tregon vendin në renditjen e vendimeve që do të shorthohen; dhe
- (2) numrin e regjistrimit të çështjes, që ka gjykuar gjyqtari.

Në listën e këtyre çështjeve përfshihen edhe ato në të cilat gjyqtari ka qenë relator i trupit gjykues, si i transferuar përkohësisht apo i caktuar për çështje të veçanta, në një gjykatë tjetër nga ajo ku ai ushtron funksionin.

<b>Tabela për çështjet me palë kundërshtare të përfunduara jashtë afateve standarde</b>	
<b>Nr. rendor</b>	<b>Nr. akti</b>
1	
2	
3	

**Hartoi**  
**Nëpunësi përgjegjës**

\_\_\_\_\_  
**(emër/mbiemër/nënshkrim)**